

Permbledhje joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne

Mjedis per aktivitetin:

“ Shfrytezim I mineralit te kromit me galeri nentokesore ”

(Sipas ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011, "Per VNM", Shtojca II, pika 2. Industri nxjerrëse - 2.2
Minierat nëntokësore;

Kerkues:

Subjekti " ALBCHROME " shpk

Ky Raport Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u hartua nga studio IbraLabs shpk:



IbraLabs sh.p.k ;

Adresa: Niesia hashkiake Nr 5 Rr "Irfan Tomini" Nr 5 Kati 1 ZK 8260

PERMBAJTJA E RAPORTIT

HYRJE

PERKUFIZIME

KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL

PERSHKRIM TE OBJEKTIVAVE TE VNM-SE

PERSHKRIMI I METODIKES SE ZBATUAR PER HARTIMIN E RAPORTIT PARAPRAK TE VNM-SE

Pershkrimi I projektit

Pershkrimi I proceseve teknologjike

- a) **Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.**
- b) **Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqene kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.**
- c) **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.**
- ç) **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.**
- d) **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.**
- dh) **Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.**
- e) **Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.**
- ë) **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.**
- f) **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).**



RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

HYRJE

Ligji i Vlerësimit të ndikimit mjedisor nr. 10 440 datë 07.07.2011 mbi “Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor” në Shqipëri thekson për përgatitjen e vlerësimeve mjedisore të çdo projekti të zhvillimit që mund të shkaktojnë ndikime në mjedisin e vendit.

Ky raport VNM-je është përgatitur sipas kërkesave kombëtare të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit të përmendura me poshtë si dhe sipas legjislacionit të BE-së marrë si referencë. Legjislacioni Kombëtar i Shqipërisë përcakton rregullat dhe mënyrat për kryerjen e një VNM-je të kësaj natyre, të cilat konsulentët i kanë konfirmuar. Ligji ka theksuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe burimet e tij duke e konsideruar atë si pjesë e trashëgimisë kombëtare e cila duhet të ruhet dhe të mbrohet për të mirën e gjeneratave të ardhshme. Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve të tij është një pararendës kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Raporti i VNM-së do të diskutojë gjithashtu mbi justifikueshmerine e projektit, alternativat e vendosjes së komponentëve të projektit të tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë dhe pas përfundimit të punimeve të propozuara.

Raporti paraparak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të paraqesë nga njera anë rëndesine e zbatimit të projektit dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutëse për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmejt tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Të paraqesë realizimin e këtij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin “e zhvillimit të qëndrueshëm”. Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i degradimit mjedisor të vendit gjatë zhvillimit industrial që mori vendi në vitet 50-të. Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë 2000 – 2009, si dhë në disa ligje e VKM të miratuara më vonë se këto vite.

Hartimi i këtij raporti VNM-je është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, date 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II i nënshtrohen Proçedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Gjithashtu hartimi i këtij raporti paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", i cili eshte perafruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Hapat e ndjekura për përgatitjen e raportit nga Ekspeti i Mjedisit janë bazuar në VKM nr. 686, datë 29.7.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore".

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Pershkrimi I projektit

Subjekti "Albchrome" shpk me administrator Z. Luan Saliaj, ushtron aktivitetin në shfrytëzimin e mineralit të kromit në zbatim të lejes minerare bashkelidhur raportit. Është hapur në vitin 1948 dhe ka vazhduar të shfrytëzojë dhe prodhojë mineral pa ndërprerje. Aktiviteti mineral ka mbi 40 vjet që kruhet në nëntokë dhe nivelet e prodhimit janë në një thellësi 700-800m nën sipërfaqe.

KOORDINATAT E VENDNDODHJES NE GAUS KRUGE

Gjeni bashkelidhur Raportit te VNM-se Lejen e Re Minerare me koordinatat e sakta te vendndodhjes se minieres



Figure – Pamje ne google maps e Minieres se Kromit, Bulqize

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Pershkrimi I proceseve teknologjike

Përgatitja dhe shfrytëzimi i bllokut bëhet me mjete të mekanizuara me goma për shpimin e birave, ngarkimin dhe transportin e mineralit dhe sterilit. Në varësi të formës, përmasave dhe elementëve të shtruarjes së trupit mineral, për cdo kat parashikohet të shfrytëzohet 9 - 10 blloqe shfrytëzimi.

Proceset e punës që kryhen në sipërfaqe të minierës janë:

1. Shkarkimi i vagonëve të mineralit dhe sterilit
2. Seleksionimi i mineralit në impiant
3. Shkarkimi i mineralit në sheshin e depozitimit të mineralit
4. Shkarkimi i sterilit në sheshin e sterilit
5. Riseleksionimi i sterilit në sheshin e sterilit

Permasat e saj gjate renies me prerjen horizontal jane si me poshte:

- Juglindje 5000 – 6000 m
- Qender 1100 – 1400 m
- Veriperendim 500 – 600 m

Permasat e saj gjate renies me prerjen terthore vertikale variojne:

- Juglindje 600 – 700 m
- Qender 1100 – 1200 m
- Veriperendim deri ne 1000 m

➤ Trupi i mineralit te kromitit dhe karakteristikat e tij

Ndertimi morfologjor - strukturor dhe karakteristikat e trupi kromitik.

Per nga ndertimi morfologjor-strukturor ky vendburim perfaqeson nje structure te permbysur antiklinale me te dy krahet e rrudhosur ne antiklinale e sinklinale me te vegjel, me sens renie jugperendimore. Pjeset e perkulura te kraheve te antiklinalit jane emertuar si trupa xeherore dhe valezimet e tyre si krahe te ketyre trupave.

Trupi kromitik vendoset singjenetakisht ne shtratimin harcburgit-dunitik. Ai ka forme damaroro- pllakore dhe eshte i rrudhosur ne planin terthor vertical e i perkulur ne planin e shtrirjes. Rralle takohen dhe format linzore. Shtrirja e pergjithshme e trupit kromitik eshte Veri Veriperendim- Jug Juglindje me azimut shtrirje 320-330°. Ne disa raste azimuti i shtrirjes se vendburimit devijon deri 230-240°. Ne teresi pjesa juglindore zhytet ne drejtim te juglindjes me kend 10-15°, ne qender e ne drejtim Veri-Veriperendim zhytet ne drejtimin veriperendimor

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

me kend 15-20°, ndersa pjesa veriperendimore e vendburimit zhytet ne drejtimin veriperendimor me kend 30-70°.

Sterilet dhe depozitimi i tyre

Ne territorin e minieres se Bulqizes jane depozituar mbi 10 milion m³ sterile. Sterilet jane rezultat i hapjes se punimeve minerare per hapjen dhe pergatitjen e minieres per nxjerrjen e mineralit te kromit. Gjate hapjes se puseve, galerive, traverbangjeve e punimeve te tjera te domosdoshme eshte nxjerre steril jashte ne siperfaqe i cili eshte depozituar prane hyrjeve te punimeve minerare. Keshtu prane puseve A1, nr. 2 dhe 3, ne kuoten +841 m, eshte depozituar sasia me e madhe e sterileve, rreth 7 milion m³.

Kjo ka ardhur si rezultat i perqendrimit te punimeve ne kete nivel, jane hapur tre puse vertikale, te cilet pervec te tjerave sherbejne dhe per punimet e thellesise. Ketu depozitohet i gjithe sterili i cili eshte rezultat i punimeve te thellesise. Vend depozitimi i madh i sterileve eshte gjithashtu dhe ne zonen e pare gal+ 1050 m dhe ne zonen D, horizonti + 1200 m.

Nxjerrja e mineralit nga sterilet

Gjate hapjes dhe pergatitjes se blloqeve te shfrytezimit, punimet minerare jo rralle kane kalluar perms trupave minerare. Meqenese keto punime benin pjese ne punimet e hapjes dhe pergatitjes per shfrytezim, i gjithe materliali i perftuar nga keto punime ishte steril dhe depozitohet ne stoqet e sterilit. Per pasoje dhe ky mineral eshte depozituar ne stoqet e sterilit. Kjo ka bere qe gjate depozitimit shumevjecare te sterileve, ato te jene perzier me mineral ne sasira qe per kohen e depozitimit kane qene te pa perfillshme. Me ndryshimin e konjukturave te tregut dhe me renien e kuotave te nxjerrjes se mineralit te kromit, duke i shtuar ketyre nevojen e tregut per mineral dhe mungesen e fronteve te punes, stoqet e sterileve u bene object i nxjerrjes se mineralit te kromit.

Ne vitin 2005 u bene disa amendamente ne ligjim minerar te vitit 1993, ne keto amendamente stoqet ne pergjithesi u konsideruan vend burim mineralesh. Per rrjedhoje te gjithe stoqet e sterileve te minierave te kromit u bene object i ligjit dhe subjekte te ndryshme u licensuan per nxjerrjen e mineralit te kromit nga stoqet e sterileve. Ne zonen e minieres se Bulqizes, veprojne rreth 3 subjekte te licensuara per nxjerrjen e mineralit nga sterilet. Normalisht qe sasite e mineralit te kromit qe nxirren nga stoqet e sterileve nuk jane te sasive te konsiderueshme, por perseri ato luajne rol ne te ardhurat e banoreve.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Koha e pergatitjes se nje blloku shfrytezimi eshte rreth 3 muaj.

Per permirsimin e parametrave teknike dhe rritjen e efektivitetit ekonomik te sistemit parashikoj me:

1. Procesi i shpimit ne pergatitjen e bllokut te shfrytezimit behet me menyren tradicionale (cekic shpues me kollone mbajttese) ndersa procesi i ngarkimit dhe transportit me ane te mjeteve me goma (mikroshkup me kove rreth 0.18 m³).
2. Per shkurtimin e kohes se pergatitjes se bllokut dhe lehtesimin e levizje se mjeteve me goma ne punimet e bllokut, kryhen punime te pjerrta, tip rampe blloku.
3. Ne nivelin e transportit te bllokut, per te mekanizuar procesin e ngarkimit te mineralit dhe sterilite perdorim ngarkues transportues me kapacitet kove 0.35 m³ - 0.5 m³
4. Per mbushjen e hapsirave te shfrytezimit parashikojme hedhjen ne to te sterileve te punimeve te hapjes, pergatitore dhe te shfrytezimit. Theksojme se per realizimin e ketij duhen rreth 68 ml punime shtese.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

POZITA GJEOGRAFIKE

Vetite fiziko-mekanike te shkembinjve

Nga studimet e kryera rezulton shkembinjte anesore, ne pjesen veriore te Vend-burimit Bulqize paraqiten me shkalle mesatare serpentinizimi (ne masen 30-40 %) dhe si rrjedhim kane tregues te larte te rezistences ne shtypje e peshes volumore.

Po ashtu, qendrueshmeria e masivit shkembor rritet ne drejtim te thellesise, si per shkak te zvogelimit te sistemit te carshmerise dhe per arsye te uljes se shkalles se serpentinizimit.

Per pjesen veriore te vend-burimit treguesit fiziko-mekanike pritet te jene si me poshte:

- Rezistenca me shtypje njeboshtore Rsh 700-800 kg/cm²
- Rezistenca ne prerje Rpr 140-180 kg/cm²

Ne treguesit te pashaportes se qendrueshmerise

- Laboratorike C = 200 kg/cm² <p1 = 37° - 39°
- Te masivit Cm= 60-120 kg/cm² <pm= 37° - 39°

Ne treguesit fizik

$$\gamma = 2.85 - 2.95 \text{ ton/m}^3$$

Larg dyshemese se trupave xeherore, shkembinjte jane mete qendrueshem, ndersa prane tyre me pak te qendrueshem. Ne zonen Veriore, pjerresia e trupave xeherore qe jane ne shfrytezim eshte mbi 45°, ndersa trashesia varion 2 - 2.5 m. Punimet minerare te kryera nga horizontet me te siperme drejt thellesise nuk kane ndryshime thelbesore pas hapjes dhe mbajtjes se tyre dhe armatimi me mure anesore ose menyra te tjera armatimi te bere kryesisht ne intervalet me prishje, ne zgjerimet dhe kryqezimet e punimeve minerare.

Gjeografia e zones dhe relievi

Miniera eshte pozicionuar ne pjesen veriore te vendburimit kromitik Bulqize, e cila ben pjese ne rajonin hidrogjeografik verilindor te vendit, qe perfshihet ne pellgjet lumore te Drinit te Zi. Terreni eshte malor dhe teper malor, I perthyer qe karakterizohet nga qafat, lugjet e majat. Ne drejtimin jugor ngrihet Mali I Dhoksit me lartesi 2024 m, ndersa ne very KKreshta I Larte 2100 m.

Rreth 75-80% e siperfaqes eshte ne lartesi mbi 1000 m. Karakteristike e relievit te kesaj zone jane majat e thepisura me nje fare rrumbullaksie asimetrike shume te pjerreta, lugje te zgjatura kryesisht gjerisht, grykat e govatat e mbyllura ne trajte cirqesh e amfiteatri si dhe rrezimet masive te shkembinjve te copetuar. Relievi paraqitet kodrinor e malor me thyrje te buta dhe vende-vende me stoqe sterile. Duke filluar nga kuota + 700m ku shtrihet qyteti i Bulqizes dhe

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

fusha e saj ne drejtimin veri-lindje-jug fillojne kodrat te cilat vazhdojne drejt malit dhe perfundojne ne Majen e Dhoksit. Duke veshtruar qytetin dhe minieren nga drejtimi perendimor perpara te shfaqet nje peizash me te gjitha karakteristikat e mundshme. Fillohet me fushen e Bulqizes ne te dyja anet e se ciles jane ndertuar dy qytete, Bulqiza dhe Bulqiza e Re. Ne vazhdim te Bulqizes fillojne kodrat te cilat ne fillim te tyre jane te zhveshura nga bimesia. Ne lartesine +800 m gjendet zona e puseve, me kullat e tyre karakteristike si dhe me repartet e minieres.

Me siper fillon te shfaqet bimesia e cila mbulon kodrat ne vazhdim deri ne Malin e Dhoksit. Pjesa e kodres ku eshte ndertuar miniera te krijon menjehere pershtypjen e peizashit industrial me stoqe sterile, minerali, objekte miniere, etj. Kjo vazhdon deri mbi zonen D ne kuoten +1200m. Mbi kete kuote dhe ne te dy anet e zones minerare takohen peme karakteristike te zones vecanerisht pisha te buta.

Kushtet klimatike

Bulqiza dhe miniera si pjese e zones se Bulqizes, karakterizohet nga klima tipike kontinentale, me vere te shkurter, te fresket e me reshje te pakta dhe me dimer te gjate, e shume te ftohte e me reshje te bollshme shiu dhe bore. Ne vendin tone Bulqiza njihet si nje nder vendet mete ftohta ne Shqiperi.

Temperaturat ne dimer shkojne deri ne -10°C e ne disa raste mjaft te rralla kane arritur deri ne -25°C , ndersa ne vere arrijne deri ne $+25-30^{\circ}\text{C}$. Ne anen ku ndodhet miniera, ana veriore e shpatit te malit te Dhoksit, pothuaj gjate gjithë dimrit, rrezet bien shume pak, dhe qe ndikon ne mos' shkrirjen e bores per nje kohe te gjate e ne temperatura mjaft te uleta.

Fryjne kryesisht erera te ftohta, te tipit murlan, fryjne vrullshem e me shpejtesi te madhe, me drejtim nga lindja per ne perendim. Kjo dhe per vete orientimin qe ka Lugina e Vajkalit. Prania e ererave te ftohta e me shpejtesi te madhe, Debora e koha e kufizuar me diell, ndikojne dukshem ne temperaturat e uleta dhe ne dimrin e acarte qe karakterizon Bulqizen.

~

Ne vere ata bien ne forme shiu, shpesh me stuhi, mjaft tipike keto per zonat e thyera malore, me lartesi + 1000 m; ndersa ne dimer ato bien ne forme shiu dhe kryesisht debore, trashesia e se ciles shpesh kalon mbi 70 cm, e me ralle deri ne 1-2 m.

Rreshjet mesatare vjetore jane rreth 1500 mm.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Flora

Zona e Bulqizes karakterizohet nga nje flore shume e pasur me elemente. Karakteristike jane pishat e bute, shkurret e uleta, dushk etj, te cilat mbulojne te gjitha

Popullsia

Qyteti i Bulqizes eshte qendra me e afert e banuar, per rreth 20 000 banore. Popullsia e ketij qyteti e cili me pare quhej qytet minatoresh ka eksperience shume te mire ne punimet minerare si te hapjes ashtu dhe te shfrytezimit. Kjo ben qe subjekti "ACR" sh.p.k e ka te lehte qe te siguroje fuqine punetore per nxjerrjen e mineralit te kromit. Si qyteti i Bulqizes ashtu dhe fshaterat jane pjese e kesaj zone krombajtese, historikisht jane marre me bujqesi e blegtori.

Meqenese keto fshatra jane vendosur ne kuota mbi +400 m mbi nivelin e detit e me lart, aktiviteti kryesor i tyre ka qene e mbetet blegtoria, pasi bujqesia eshte pak e veshtire ne keto zona. Ndertimi i kesaj miniere ne vitin 1946 krijoi mundesine e hapjes se shume vendeve te punes, jo vetem per kete zone por ne minieren e Bulqizes jane punesuar dhe banore nga Peshkopia. Pra, te gjitha keto cojne ne zbutjen e papunesise.

Ekosistemet, peisazhet dhe peizashi ekzistues

Miniera Bulqize ben pjese ne zonen kodrinore malore te rrethit te Bulqizes, ajo ka nje peisazh terheqes, shpate kodrash, male, fusha e Bulqizes ne mes dy vargmalesh, etj. Kjo miniere dhe nxjerrja e mineralit nga ajo nuk dote demtoje e prishe peizashin apo ekosisteme ekzistuese. Gjithashtu vlen te permendet fakti se miniera Bulqize nuk ben pjese ne zonat e mbrojtura dhe ne monumentet e natyres te qarkut Diber rrethi Bulqize.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.

Zona karakterizohet nga nje flore shume e pasur me elemente. Karkateristike jane pishat e buta, shkurre te uleta, dushk etj. te cilat mbulojne siperfaqen e kodrave mbi zonen e puseve deri ne majen e Dhoksit, duke perjashtuar siperfaqen ku ushtron aktivitetin miniera. Duke qene nje miniere ekzistuese, elementet e flores jane te pakta. Gjithashtu ne kete zone rriten dhe dellinja e kuqe, e zeze dhe sherbela, pa perjashtuar barishtet e shkurret e ndryshme.

b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.

Jane te tipit te carjeve dhe nuk kane nje shpemdardje te njetrajtshme. Prurjet e tyre varen nga thellesia e punimeve, por edhe nga ushqimi qe u behet nga ujrat siperfaqesore, duke kaluar ne thellesi. Sasia e ketyre ujrave rritet ne periudhat me rreshje edhe gjate shkrirjes se debores.

Terreni shume i thyer, ne zonen ne fjale, lejon grumbullimin e nje sasie te madhe uji. Sasite me te medha te ujrave siperfaqesore qe rrezikojne pjesen Veriore te Minieres, Puset e thellesise te Zones Veriore, vijne nga keto drejtime:

- Ujrat qe vijne nga pjesa lindore e zones "D", ku burim kryesor eshte perroi qe zbret nga maja e Dhoksit te Galeria Nr.46 dhe perroi qe zbret nga pjesa lindore e Dhoksit, ne anen e majte te Galerise c (+1140 m) te Galerite 12, 12 biz, so. SO', 63, 27 e 57. Te dy keta perrenj bashkohen dhe zbresin deri ne zonen e pare. Ne shtratin e ketij perroi nga jugu (pjesa me e siperme) drejt veriut vendosen Galerite 66, 65, 53, 29, 30 biz, 45, A1 dhe 1
- Ujrat qe vijne nga perrenjte mbi Galerite 44 dhe 48 dhe qe grumbullohen ne stoqet e ketyre galerive, deri ne Galerine 43.
- Ujrat qe vijne nga perrenjte e Zones Perendimore, perrenj, te cilet krjohen nga rreshjet e shiut, sidomos ne periudhen e shkrirjes se debores.

Sasite e tyre ndryshojne ne varesi te reshjeve atmosferike. Burimi i pare i ujrave vjen nga pjesa lindore e zones D, ku ka sasi me te madhe uji.

Kushtet hidrogeologjike

Ujrat nentokesore te vend-burimit Bulqize jane te sistemit te carjeve dhe linjave tektonike me origjine siperfaqesore. Prurjet e tyre ne varesi te reshjeve dhe thellesive. Ato jane me intensive ne stinet me rreshuje te medha dhe drejt thellesise debit ii tyre ulet per shkak te kompaktesise se shkembinjëve, renies se densitetit te sistemit te carjeve, te dendesise se linjave tektonike dhe rritjes se gradientit gjeotermik.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Ujrat e pellgut artesian te lugines se Vajkalit, qe jane te bollshme mbeshteten mbi nje pako te fuqishme argjilash, qe sherben si ekran mbrojtës për mosdepertimin e tyre ne kompleksin e shkëmbinjve ultrabazike, e për pasoje edhe ne kompleksin e punimeve minerare.

Perberja e tyre është e tipit krabonatiko-magneziale, me mineralizim te pergjithshem 0.33-0.40 gr/liter. Ambjenti është bazik, me pH=8.2, ndersa fortesia e pergjithshme është e ulet dhe varion ne kufijte 9.5-11 grade gjermane. Sipas te dhenave faktike dhe studimeve te kryera nga Ndermarja Hidrogjeologjike Tirane, permbledhur ne studimin "Mbi hapjen dhe shfrytezimin e Zones Veriore te Vend-burimit Bulqize nen nivelin e y-te,, prurjet e ujrave per zonen veriore rezultojne si me poshte:

- Uji i brekceve (nxirret nga niveli i dyte dhe pusi) 2.3 lit/sek.
- Uji qe zbret deri ne nivelin e v-te 94 lit/sek.
- Gjithsej mbi nivelin e v-te 117 lit/sek.
- Ujra nga niveli i v-te deri ne nivelin e x-te 22.4 lit/sek.
- Ujra nga niveli i 1x-te deri ne nivelin e XVU-1e (kuota -60 m) 44.8 lit/sek.
- Ujra nen nivelin xvu-te 28 lit/sek.

Mesatarja e ujrave qe futen ne thellesine e minieres është 70-80 l/s. nga studimet e kryera deri tani prurjet specifike për 1 ml ulje jane pranuar 0.14 l/s për punimet ne thellesi te minieres.

Karakteristikat hidrografike

Miniera e Bulqizes ne siperfaqe, nderpritet nga Perroi i Duricit dhe disa perroska te vogla qe sjellin uje vetem ne kohe reshjesh intensive. Ky perrua kalon rreze shpatit te minieres, dhe sjell uje ne sasira te medha ujrash ne stinen e pranveres, vjeshte e dimer si dhe ne kohe rreshjesh.

Ky uje, kur futet ne territorin ku ka zhvilluar aktivitet miniera e Bulqizes, deperton neper carjet e siperfaqes, te shkaktuara nga shfrytezimet e kahershme nentokesore dhe rrjedh neper punimet minerare. Shpesh here ai shkakton permbytje te punimeve, pasi edhe carjet e siperfaqes jane zmadhuar, për shkak te riaktivizirnit te hapesirave te shfrytezimit nga aktiviteti minerar I zhvilluar prej subjekteve private. Disa here për devijimin e ketij perroi është projektuar kanali I devijacionit te ujrave te larta e jane ndermarre nisma për realizimin e tij , për deri sot nuk ka gj etur zbatim perfundimtar. Perroi i Duricit rrjedh ne drejtim te veriut dhe bashkohet me Perroin e Vajkalit, afersisht tek ura qe lidh Qytetin e Ri me ate te Vjeter Bupqize, për te rrjedhur me tej ne lumin e Drinit. Ne stinen e veres ky perrua shteron. Perroskat, ne kohe reshjesh intensive, sjellin me vehte shume material te ngurta terrigjene, qe shpesh here krijojne llurba te rrezikshme.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Ujerat siperfaqesore

Jane te tipit te carjeve dhe nuk kane nje shpemdardje te njetrajtshme. Prurjet e tyre varen nga thellesia e punimeve, por edhe nga ushqimi qe i behet nga ujerat siperfaqesore, duke kaluar ne thellesi. Sasia e ketyre ujerave rritet ne periudhat me rreshje edhe gjate shkrirjes se debores.

Terreni shume i thyer, ne zonen ne fjale, lejon grumbullimin e nje sasio te madhe uji. Sasite me te medha te ujrave siperfaqesore qe rrezikojne pjesen Veriore te Minieres, puset e thellesise te Zones Veriore, vijne nga keto drejtime:

- Ujrat qe vijne nga pjesa lindore te zones "D", ku burim kryesor eshte perroi qe zbret nga maja e Dhoksit te Galeria Nr.46 dhe perroi qe zbret nga pjesa lindore e Dhoksit, ne anen e majte te Galerise C (+ 1140 m) te Galerite 12, 12 biz, 50, 50', 63,27 e 57. Te dy keta perrenj bashkohen dhe zbresin deri ne zonen e pare. Ne shtratin e ketij perroi, nga jugu (pjesa me e siperme) drejt veriut vendosen Galerite 66, 65, 53, 29, 30 biz, 45, A1 dhe 1.
- Ujrat qe vijne nga perrenjte mbi Galerite 44 dhe 48 dhe qe grumbullohen ne stoqet e ketyre galerive, deri ne Galerine 43.
- Ujrat qe vijne nga perrenjte e Zones Perendimore, perrenj, te cilet krijohen nga rreshjet e shiut, sidomos ne periudhen e shkrirjes se debores.

Keto burime kryesore te grumbullimit te ujrave, per nga sasite, ndryshojne ne varesi te rreshjeve atmosferike qe bien gjate stineve te vitit. Duhet theksuar se burimi i pare i ujerave, ai nga pjesa Lindore e Zones "D" eshte me kruesori, ka sasi me te madhe uji, e cila vjen gjate gjithë vitit. Dy burimet e tjere ne stinen e veser kane prurje te vogla uji.

Si rezultat i ndodhjes se trupave te kromit te shfrytezuar afer siperfaqes, vete siperfaqja e tokes mbi keto trupa ka pesuar carje tern adhesive te ndryshme. Jane evidentuar 10-12 hinka dhe ka edhe shume te mbuluara. Ka mbi 70 raste ne pozicione te ndryshme te siperfaqes, ku krahet e trupit kane dalje ne siperfaqe dhe mbas shfrytezimit, keto dalje luajne te njejtin rol si dhe hinkat.

Ujerat nentokesore

Hapja e minieres ne disa nivele, nga kuota + 1440 m deri ne kuoten- 6m, shfrytezimi I trupave minerar dhe lidhja e niveleve me punime minerare, ben qe ujrat e minieres te shkojne gjithnje nga nivelet e mesiperme ne ato te poshtme. Kjo ndihmohet dhe nga tektonika e theksuar qe karakterizon kete miniere.

Ne minieren e Bulqizes ka disa pika nga te cilat dalin ujrat nentoksor. Per kuota qe jane mbi kuoten + 1200 m, zona D, te gjithë ujerat dalin nga galleria A, ne kete nivel. Ne kete galeri ne thellesine mbi 1 km eshte ndertuar dhe depo e ujit qe furnizon Bulqizen me uje te pishem. Per

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

nivelet mbi horizontin + 1050, te gjitha ujrat dalin nga traverbanku + 1050m, pra ketu mblidhen ujrat nga kuota me e siperme +1200 m e deri ne kuoten +1050m. Per nivelet e

Me poshtme ujrat dalin nga pusi A1 ne kuoten +820m. Nga ky pus dalin ujrat qe grumbullohen nga kuota 1050m e deri ne kuoten +450m, niveli I V. Ujrat ketu vijne per vet rrjedhje dhe grumbullohen ne stacionin e pompimit. Ne kete stacion vijne dhe ujrat e niveleve te meposhtem nga I V deri tek niveli XVI. Ujrat nga nivelet e meposhtme deri ne nivelin e V dergohen me ane te pompave te cilat jane instaluar ne stacionet e grumbullimit te ujrave ne nivelet perkatese. Pra ujrat qe vijne nga lart nga kuota + 1050 m nepermjet vetrrjedhjes dhe ujrat qe vijne nga poshte nga kuota - 5m me ane te pompimit, grumbullohen se bashku ne stacionin e pompimit ne nivelin e V, kuota +450 m.

Nga ky stacion me ane te pompave te fuqishme nepermjet sistemit te tubacioneve, ujrat dalin ne sipërfaqe. Nga miniera e Bulqizes ne sipërfaqe shkarkohen dhe sasira te konsiderueshme uji, rreth 170 litra ne sekonde, uje qe grumbullohet ne nentoke.

Nga analizat rezulton se keto ujra jane karbonato magneziumit me mineralizim te pergjithshem 0.30 - 0.40 gr/liter me reaksion te ujit bazik ku pH mbi 8 dhe fortesia e pergjithshme e ujit eshte ne kufij te ulet 9.5 deri 11° gjermane.

Nje pjese prej 150 litra/sek shkon ne miniere per procesin teknologjik, ndersa pjesa tjeter nga sipërfaqja me vet rrjedhje kalon ne lumin e Vajkalit, 1 km posht objektit, sebashku me ujrat e zones Jugore te minieres (rreth 120 litra/sek si mesatare vjetore) dhe bashkohet me Drinin e Zi, me tej ne liqenin e Fierzes e deri ne detin Adriatik.

c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.

o Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer

NDIKIMI I MUNDSDHEM	PASOJAT NE MJEDIS
Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet, ngarkim transportit	Sasia e gazeve NOx dhe SOx qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara
Shqetesim i mjedisit nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Emetim zhurmash te mjeteve te transportit te mineralit te kromit
Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit	Ndotje e ajrit nga mjetet e transportit

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Ndikimi si rezultat i shpimit me plasje	Do te gjenerohet pluhur si rezultat i shpimeve me plasje
---	--

○ **Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke**

NDIKIMI I MUNDSHEM	PASOJAT NE MJEDIS
Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te transportit te mineralit jane te kufizuara ne siperfaqen e minieres.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes	Ndotje e tokes si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete ne sasi te vogla.
Erozioni minimal ne kohe me rreshje ne pjeset anesore te rruges dhe stoqeve te sterilite	Levizjet e grimcave te tokes te ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt kuotave me te uleta te siperfaqes dhe ne nentoke apo drejt trupave ujore si proska e perrenjte ne afersi te minieres.
Depozitim ne siperfaqe, I sasive te konsiderueshme sterile qe dalin nga miniera	Zenia e siperfaqeve nga sterilet e minieres.
Vibracion si pasoje e punimeve minerare te hapjes	Lekundje e formacioneve te nentokes qe rrethojne punimet minerare te shfrytzezimit dhe hapjes
Shqetesim i nentokes per shkak te shfrytzezimit te mineralit te kromit	Krijimi i hapësirave ne nentoke
Vibracion si pasoje e puneve te shpimit plasjes per nxjerrjen e kromit	Lekundje dhe dridhje te nentokes, shkembinjte rrethues te trupit minerar.

○ **Mbetjet e ngurta**

NDIKIMI I MUNDSHEM	PASOJAT NE MJEDIS
Gjenerim I mbetjeve nga aktiviteti njerezor	Ndotje nga saktiviteti njerezor, me kartona, bidona vaj i, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet
Sasira te konsiderueshme te sterilite	Zenia e siperfaqeve per stoqet e depozitimit te sterileve

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

o Identifikimi I ndikimeve te mundshme negative ne peisazh

NDIKIMI I MUNDSEHEM	PASOJAT NE MJEDIS
Ndryshime ne pejsazh dhe topografi si rezultat I depozitimit te sterileve	Ndryshime ne pejsazh dhe reliev si rezultat I depozitimit te sterileve dhe krijimit te stoqeve te sterileve gjate jetes se minieres.
Ndryshime ne pejsazhin e topografine e terrenit ku ndodhet objekti nga hapja e galerive dhe puseve.	Nderhyrje ne siperfaqen e tokes, ndryshime te vogla te pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te pejsazhit

ç) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.

Miniera e Bulqizes ka mbi 75 vite ne aktivitet pasi eshte krijuar qe ne vitin 1942 dhe do te vazhdoje te funksionojë per nje periudhe pa caktim per nxjerrjen dhe shfrytezimin e mineralit te kromit. Gjithcka eshte ne varesi te intensitetit te punimeve ne kete miniere.

dh) Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk do te kete ndikime negative dhe aq me pak te shtrira ne hapësire tizike se kjo veprimtari nuk ka ndikime te qenesishme, edhe ato qe mund te shkaktojne ndotje dote parandalohen me marrjen e masave.

d) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.

Subjekti ka hartuar nje plan rehabilitimi, i cili do te zere zbatim ne momentin qe ky aktivitet do pushoje se funksionuari. dhe masat qe dote merren per rehabilitimin e tij jane si me poshte.

Punime inxhinierike jane si me poshte:

- o Mirembajtja e hyrjeve te purumeve mmerare horizontale dhe vertikale me dalje ne siperfaqe.
- o Mirembajtja e rrjetit rrugor te minieres.
- o Hapja e kanaleve per drenazhimin dhe disiplinimin e ujrave.
- o Mbyllja e hyrjeve te punimeve minerare horizontale e vertikal me dalje ne siperfaqe.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Punime biologjike:

- Mbjellja e druveve autoktone te zones duke qene se zona i ka te tille
- Mbjellja e bimesise
- Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

Gjate rehabilitimit te mjediseve ne minieren e Bulqizes, duhet te merren parasysh faktoret e meposhtem:

1. Rezervat e mineralit dhe jeta e minieres.
2. Trashegirnja, ndertimet siperfaqesore, stoqet e depozitimit te sterileve, sheshet e depozitimit te mineralit e materialeve.
3. Perjashtimi nga projekti i rehabilitimit i ndertimeve siperfaqesore
4. Ushtrimi i aktivitetit te nxjerrjes se mineralit nga nentoa, nepermjet galerive te cilat dalin ne siperfaqe brenda territorit te ACR.
5. Vazhdimin e depozitirnit te sterileve
6. Vazhdimin e nxjerrjes se mineralit te kromit e aktivitetet e tjera ndihmese nga subjekti jone dhe nga subjekte te tjera.

Plani i rehabilitimit ne kete miniere do te kete dy faza qe dote orientohen ne:

FAZA I - Do vazhdoje derisa te jete jeta e minieres. Mirembajtja e rrugeve te transportit, ndertimeve siperfaesore, e hyrjeve te punimeve minerare vertikale dhe nentokesore; pastrimi e sistemimi i shesheve te depozitimit te mineralit e shesheve te punes; rrethimi i zones se rrezikshme e monitorimi i saj .

FAZA II - Do te filloje menjehere sapo te mbaroje nxjerrja e mineralit nga nentoka e do vazhdoje deri ne rehabilitimin perfundimtar. Heqja e pajisjeve e makinerive nga nentoka e siperfaqja, pastrim i shesheve te depozitimit te mienralit nga pajisjet e makinerite, mbulim me shtrese dheu fertil nga 0.4-0.5 m, i shesheve te mineralit dhe atyre te punes. Krijimi I siperfaqeve per mbjellje, mirembajtja e rrugeve dhe kanaleve, mirembajtja e siperfaqeve te mbjella.

Kjo faze mund te filloje ne vartesi te niveleve, pra nga me i sipermi duke zbritur poshte, mjafton qe ne nivelin qe behet rehabilitimi te mos kete rezerva minerali.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.

Territori ku do te kryhen punimet do te mirembahet sepse sterilet dhe dheu dote sistemohen ne stoqe dhe nuk dote kete ndikime negative ne mjedis. Tokat dote jene te mbrojtura nga erozioni pasi do te ndertohen kanale per kalimin e ujerave duke shmangur keshtu derdhjen e tyre ne toka.

Mjetet e transportit kontrollohen nga ana teknike ne menyre qe mos te kene defekte dhe zhurnat qe shkaktojne te jene brenda parametrave te lejuar per zhurmat. Keshtu nuk dote kete ndikime negative ne mjedis dhe ne ajer. Gjithashtu per mos te shkaktohet ndotje te ajrit nga pluhurat qe ngrihen nga levizjet e mjeteve te transportit merret si mase paraprake lagia me uje e rrugeve. Jane marre masa per minimizimin e sasive te sterilit qe del ne siperfaqe dhe grumbullimin dhe depozitimimin e mbetjeve urbane ne vende te percaktuara per to duke shmangur keshtu ndotjen. Lekundjet qe shkaktohen nga punimet per nxjerrjen e mineralit te kromit dote kryhen thelle nentoke dhe ne parametrat e lejuar keshtu qe nuk do te kete ndotje nga zhurnat dhe vibracionet.

1. Masat zbutese per ndikimet ne toke

Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj.	Transporti eshte proces i pashmangshem per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes ka vend te caktuar me kushte optimal. Perdoren rruget qe jane hapur qe ne fillim.
Depozitim ne siperfaqe i sasive te konsiderueshme sterile qe dalin nga miniera.	Sistemin dhe qendrueshmeri ne stoqet e sterileve duke futur elemente per te siguruar qendrueshmeri dhe ruajtur kendin e qendrueshmerise se shpatit te stokut te sterilit, 45°
Erozion minimal ne kohe me rreshje ne pjeset anesore te rruges dhe stoqeve te sterilit.	Stoqet e sterileve dhe rruget rrethohen nga kanale ne te cilat kalon uji i shiut duke shmangur ne kete menyre erozionin qe mund te shkaktojne ujerat e shiut.
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Te gjitha pajisjet e makinerite kontrollohen e mirembahen vazhdimisht. Mjetet e transportit jane objekt i kontrollit teknik vjetor. Gjithashtu defektet dhe te

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

	metat riparohen menjehere sapo konstatohen.
Vibracion si pasoje e punimeve minerare te hapjes	Keto punime zhvillohen ne thellesi ne nentoke shume larg nga siperfaqja si horizontalisht(mbi 100 m) ashtu dhe vertikalisht.(kuota 260 deri Sm)

2. Masat zbutese per ndikimet ne ajer dhe mbetjet e ngurta

Ndotje e ajrit nga tymrat dhe shkarkimet nga mjetet e transportit	Mjetet e transportit jane objekt i kolaudimit periodik, gjithashtu ato jane objekt i kontrollit nga vete subjekti. Ne rastet kur keto mjete emetojne gazra mbi normat e lejuara si rezultat i defekteve, menjehere ato hiqen nga qarkullimi dhe behet riparimi i tyre.
Zhurma nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes	Makinerite e pajisjet emetojne zhurma brenda kufijve te lejuar, po keshtu edhe mjetet e transportit, ato jane objekt i kolaudimit vjetor. Ne rastet aksidentale, mjetet dhe makinerite nxirren jashte skemes se punes, riparohet defekti pastaj rifuten dhe njehere ne pune.
Ndotje e ajrit nga pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve brenda territorit te minieres.	Ne rastet kur ngrihet pluhur, ne ato pjese te rruges behet lagia me uje, per te eliminuar ngritjen e pluhurit.
Ndotje e ajrit nga pluhuri si pasqje e punimit me shpim plasje.	Ne keto raste behet lagia me uje perpara shpimit me menyre qe te minimizohet sasia e pluhurit te gjeneruar. Punonjesit do te jene te pajisur me maska, ndersa ne zonat e banuara nuk do te kemi ndikime pasi miniera eshte larg zonave te banuara dhe shpimet behen brenda ne miniere jo ne ambient te hapur.
Depozitim i sasirave te konsiderueshme te sterilite	Minimizim i sterilite qe del ne siperfaqe dhe depozitim i tij ne stoqet e trasheguara te sterileve.
Ndotje si rezultat i gjenerimit te mbetjeve nga aktiviteti njerezor.	Grumbullim ne vendet e percaktuara per depozitim dhe trajtimi si mbetjet e tjera urbane.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Rreziku ne shendet dhe masat per zbutjen e tij ,masat e sigurimitm teknik

Administratori dhe drejtuesi teknik i shoqerise bejne vazhdimisht instruksionin teknik te punonjesve .

- ✓ Nje metode efikase mbetet trajnimi teorik jo me shume se tre jave dhe trajnimi ne pune.
- ✓ Si trajnim ne pune keshillohet te punohet ne mbikqyrje per jo me pak se nje jave ne te gjitha proceset e prodhimit.
- ✓ Per evidentimin e efektit te zhurmave, pluhurave, gazrave punonjesit e impiantit gjate operacioneve qe gjenerojne zhurma, pluhura, ujra, gazra sic jane percaktuar ne pjesen ku trajtohen ato eshte i nevojshem perdorimi i aparaturave perkatese per kapjen e zhurmes, filtrave per kapjen e pluhurave dhe gazeve, trajtimin e ujrave teknologjike.
- ✓ Per reagimin e menjehershem ndaj aksidenteve te mundshem humane, objekti disponon edhe nje ambient ku mbahet kutia e ndihmes se shpejte dhe vendosen mjetet personale te punonjesve. Celsat e ketij ambienti ruhen me kujdes dhe njekohesisht jane ne dispozicion te kujdo qe nevojitet ne cdo ore te dites.
- ✓ Per uljen e rrezikut te aksidentimit te punonjesve dhe banoreve nga mjetet e transportit brenda objektit dhe ne rrugen kryesore, shpejtesia e mjeteve te mos i kaloje 20km /ore brenda objektit dhe 60 km/ore ne rrugen kryesore.

Sigurimi teknik ne proceset e punes

Gjate ushtrimit te aktivitetit ,subjekti mban parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz.

1. Para se gjithash ne te gjitha operacionet jane punesuar specialist me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te ndryshme te perdorimit te instalimit.
2. Rregullore e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te drejtimit te operacioneve, zbatohet ne cdo proces pune te percaktuar ne plan organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga ai dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes.
3. Plan organizimi i punimeve hartohet para fillimit te cdo operacioni te funksionimit te aktivitetit .
4. Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve.
5. Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar ben kontrollin teknik dhe azhomimin e sakte te punimeve te cdo lloji per te cilat subjekti ka marre license.
6. Rradha e kryerjes se veprimeve percaktohet hollesisht ne planin e masave teknikoorganizative dhe eshte i miratuar nga perfaqesuesi i shoqerise.
7. Ne kete plan tekniko-organizativ masat e teknikes se sigurimit zene vendin kryesor.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

8. Drejtuesi teknik i punimeve kryen instruktive te rregullta mujore e tre mujore , ku trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet dhe operacionet qe zhvillohen brenda instalimit per perpunimin e mineralit te kromit.
9. Kujdes i vecante i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes se mjedisit te zones.

Detyrimet e punëdhënësit

Punëdhënësi vetë ose nëpërmjet drejtuesit teknik që ka punësuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që :

- Të sigurojë për çdo rast ndihmen e parë mjeksore.
- Të vendos në territorin e instalimit , në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë instuktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerit apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë ç'masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Plani i monitorimit te mjedisit

PMM-ja per nje komponent projekti apo nje nenprojekt do te permbaje:

- Vleresimin e impakteve mjedisore te parashikuara ne faza te ndryshme, veanerisht gjate funksionimit (perfshire mirembajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjate te cilave do te kryen fazat e mesiperme, shkallen e tyre, qellimin dhe pasoja(t).
- Percaktimin e nivelit te pranueshem te secilit impakt, vecanerisht ne lidhje me periudhen kohore, zgjatjen ne kohe, shkallen, pasojen (t), koston (t), dhe nivelet e lejuara ligjore.
- Kushtet dhe masat qe duhen ndermarre per te zbutur keto impakte qe ka mundesi te dalin ne do faze, cilet do te jene pergjegjes per to, nese duhet permiresuar projekti teknik, ose nepermjet masave mbrojtese gjate funksionimit, apo metoda te tjera, koston e mundshme, implikimet per perfundimet e projektit, etj.
- Burimet dhe metodat e kerkuara per monitorimin, matjen dhe venien ne zbatim te tyre (fare eshte per t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); pergjegjesite institucionale per secilin veprim; dhe kerkesat e nevojshme per ngritjen e kapaciteteve, dhe koston perkatese te secilit element.
- PMM-ja do te permbaje dy dokumente te vecanta: nje Plan Zbutes, qe merret me aspektet e pershkuara me siper, dhe nje Plan Monitorues qe merret me aspektet e pershkuara me siper. Pritet qe te pergatiten ne kohen e finalizimit te perfundimit te projektit teknik dhe duhet te permbaje te gjitha kerkesat e specifikuar ne Vendimin Paraprak te VNM-se te leshuar nga AKM-ja.
- NJQV-ja ose propozuesit (nese nuk jane te njejte) do te jene pergjegjes per pergatitjen e PMM-se. Megjithate ne Termat e References se projektuesit te projektit perfshihet pregatitja e PMM. Aty ku nenprojekti kerkon nje VNM, do te kerkohet mendimi i specialisteve te VNM para se ky i fundit te finalizohet.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Qellimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe.

Procesi i monitorimit eshte procesi i vezhgimit dhe mbledhjes te te dhenave ne menyre periodike ose te vazhdueshme mbi fenomenet natyrore qe zhvillohen ne objekt, si pasoje e aktivitetit te nxjerrjes se mineralit te kromit. Disa nga indikatorët qe duhen monitoruar per te vleresuar suksesin dhe matur realizimin e objektiveve mjedisore te projektit jane:

- Monitorimi i zhurmave te mjeteve te ngarkim-transportit
- Monitorimi i biodiversitetit ne zonen rreth minieres
- Monitorim i pluhurave ne objekt dhe gjate transporti
- Monitorimi i gjendjes se mekanikes dhe mundesise per rrjedhje dhe ndotje
- Monitorim i faktoreve qe shkaktojne fatkeqesi natyrore dhe humane
- Monitorim i zones se rrezikshme te trasheguar te minieres
- Monitorim i gjendjes se stoqeve te sterility
- Monitorim i ujrave qe dallin nga miniera
- Monitorim i gazeve ne nivelin VIII dhe IX

Objektivat e Monitorimit:

- Te krahasoje cilesine dhe gjendjen e mjedisit para fillimit te aktivitetit me ate gjate funksionimit te Minieres se Bulqizes.
- Te monitoroje emetimet (nese ka) ne te gjitha fazat e zhvillimeve te projektit ne perputhje me normat dhe standardet ligjore te Shqiperise dhe BE.
- Te percaktoje nese ndryshimet e mundshme mjedisore jane si rezultat i zhvillimeve te aktiviteteve qe kryhen ne rajonin e projektit dhe nese ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin e propozuar.
- Per te percaktuar efektivitetin e masave permiresuese te zbatuara nga aktoret zhvillues te projektit ne rajon.
- Per te percaktuar impaktet afatgjate (nese ka).
- Per te percaktuar zgjatjen e kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajonin e projektit ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte nete.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- Te krijoje nje arkive te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.
- Per te garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisor per tu perdorur per qellim te caktuar.

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit eshte detyrim ligjor, menyra, frekuenca dhe elementet e monitorimit jane te ndryshem per veprimtari te ndryshme.

Kerkesa ligjore re per kryerjen e monitorimit:

Ligji nr. 10431 date 09.06.2013 "Per mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "monitorim i gjendjes se mjedisit"; Subjekti eshte i detyruar te kryeje monitorimet periodike sipas kerkesave te percaktuara ne kushtet e Vendimit Paraparak te VNM-se ose te lejes se mjedisit pasi subjekti te pajiset me to .

Monitorimi

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit. Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje rregjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne Drejtorine Rajonale te mjedisit sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve. Persa i perket monitorimeve te komponenteve te cilat shoqeria nuk i ben dot matjet do te lidh kontrate me subjekte me laboratore mjedisore te akredituar te cilet do te monitorojne ecurine e shkarkimeve te ketyre komponenteve.

Programi i vetmonitorimit

Monitorimi ne vetvete eshte nje proces i zbulimit te ndryshimeve nese ato ndodhin, si dhe i percaktimit te drejtimit dhe matjes se shtrirjes se tyre. Monitorimi mjedisor i aktivitetit ka si qellim te ofroje te dhena lidhur me ndikimet faktike ne mjedis te aktivitetit gjate fazes se ushtrimit te veprimtarise si dhe marrjen e masave te nevojshme per rritjen e performances mjedisore te veprimtarise. Indikatoret dhe parametrat e monitorimit mjedisor do te perqendrohen kryesisht ne shkarkimet ne mjedis te veprimtarise edhe pse ato parashikohen minimale per shkak te natyres se aktivitetit dhe teknologjise qe do te perdoret.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Monitorimi do te kryhet nga vete investitori dhe ne rast te pamundesise teknike per realizimin e tyre do te kerkohet bashkepunimi i subjekteve te specializuara per fushat perkatese.

Elementet e monitorimit mjedisor te veprimtarise

NR	ELEMENTI I MONITORUAR	FREKUENCA	SHPJEGIME
1	Monitorim i kushteve te punes dhe pajisjeve	Vazhdueshem	Eshte e rendesishme qe kushtet e punes te jene sa me te mira si dhe pajisjet te mos kene difekte teknike, nese ndodh dicka e tille merren masat e menjehershme per riparimin e tyre.
2	Monitorim i zhurmave	Vazhdueshem	Monitorohen sipas kushteve te lejes se mjedisit
3	Monitorimi i pjeseve te procesit teknologjik ku ruhen produktet qe dalin nga procesi	Vazhdueshem	Eshte e rendesishme gjithashtu edhe kushtet e ruajtjes se produkteve qe dalin nga procesi
4	Monitorim i te gjithe masave te parashikuara per zbutjen e ndikimeve	Periodik	Behen analize dhe shqyrtim i efektivitetit te masave te marra hap pas hapi

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

PLANI I PËRBALLIMIT TË EMERGJENCEAVE

Shoqëria “Albchrome” sh.p.k në veprimtarinë e saj, detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

- Rënia e zjarrit

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në Shoqëri vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse.

Brenda aktivitetit do të funksionojë edhe lidhja telefonike dhe telefonat celulare që janë vendosur në dispozicion për lajmërimin e zjarrfikësve. Personeli present bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit. Pajisjet dhe instalimet do të mbrohen me sistemin e shkumës antizjarr, si dhe shuarës zjarri portable dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

- Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri

Pozicioni i objekteve/instalimeve përbërëse të subjektit, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre.

- Rënia nën tension

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty. Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë instaluar pajisjet dhe impianti, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do i pajise me uniforma dhe mjete mbrojtese.

- **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjithë treguesve te percaktuar. Kontrolli dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqeri do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerezve dhe mjedisin perreth.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Tezbatohet projektii propozuar per shfrytezimin e kromit me galeri nentokesore.
- Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe bime dekorative autoktone ne kushte artificiale per te rritur koeficientin e gjelberimit.
- Sipas ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" Grumbullimi i mbeturinave, ngarkimi, transporti tyre do te behet konforme kerkesave dhe rregullave mjedisore, ato do te evadohen brenda nje afati te percaktuar per te mos penguar punimet dhe ndotur me tej ambientin
- Jane marre te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar aksidentet dhe per te minimizuar ndikimet e tyre. Aktiviteti nuk perdor lende te demshme dhe te rrezikshme si per mjedisin ashtu edhe per punonjesit. Per shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Mbrojta e shendetit dhe siguria ne pune jane ne qender te vemendjes te shoqerise.
- Mbrojtja ndaj zjarrit vleresohet si nje nga prioritetet kryesore te shoqerise . Edhe shkarkimet atmosferike jane nje burim potencial i renies se zjarrit ne objekt. Te gjitha objektet me lartesi si shtylla ndricimi dhe shtyllat e furnizimit me energji elektrike ajrore jane te perfshira ne sistemin e mbrojtjes nga renia nen tension.
- Te shmanget ne maksimum te reduktohen zhurmat ne oret e vona.
- Te kryhet rrethimi i Minieres se Bulqizes me qellim mbrojtjen e banoreve perreth.
- Te reduktohet qarkullimi i mjeteve te lenedeve te par ate kromit ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar nezone.
- Te mos perdoren borite e mjeteve ne qendrat e banuara dhe qarkullimi te kryhet me shpejtesi te ulet.
- Te vendosen kontenier per mbajtjen paster te ambjenteve nga mbetjet urbane dhe te paguhen te gjitha taksat vendore per nje mjedis sa me te paster.
- Investitori te respektoje detyrimet e vendosura ne Vendimin Paraparak te VNM-se qe do te miratohet nga AKM.

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- Subjekti te respektoje te gjitha masat zbutese dhe lehtesuesee percaktuara ne kete raport te VNM.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.
- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi.
- Si rezultat i realizimit te projektit nuk do te absorbohen ndikime te rendesishme mjedisore, sociale ne shendetin e njerezve. Per pasoje ndikimet e parashikuara mund te minimizohen duke zbatuar masat e permendura me siper.
- Per ndikimet e identifikuara jane propozuar masat perkatese me qellim minimizimin dhe eleminimin e ketyre impakteve.
- Eshte detyre e zbatuesve te projektit te integrojne elementet e domosdoshem te propozuar per parandalimin, minimizimin dhe eleminimin e ndikimeve negative ne mjedis, shendet dhe aspektin social.
- Eshte detyre e Njesise Administrative Vendore gjithashtu te zbatoje rigorozisht detyrimet e percaktuara per te garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit.
- Eshte detyre e te gjitha kontraktoreve e nenkontraktoreve te ndryshem qe gjate fazes se funksionimit te zbatojne me kujdes detyrimet perkatese te parashikuara me siper.
- Operatori te pajiset me leje mjedisi te tipit B osee tipit A (ne varesi te kapacitetit shfrytezues) per aktivitetin "Miniere e shfrytezimit te kromit me galeri nentokesore" me qellim percaktimin e kushteve specifike te operimit te instalimit.
- Te zbatohen detyrimet qe rrjedhin nga ligji Nr. 10 448/2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligji Nr. 10 440/2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"
- Te zbatohet Vendimi Nr. 371, date 11.06.2014 "Per Miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit te tyre" dhe Vendimi Nr. 229, date 23.04.2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe informacionit qe duhet te perfshihet ne dokumentin e transferimit".

RAPORTI PARAPRAK I VLRESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

e) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).

Aktiviteti nuk ka ndikime ne mjedisin nderkufitar pasi zhvillohet brenda territorit te Republikes se Shqiperise .

Ky Raport Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u hartua nga studio mjedisore IbraLabs shpk:

